



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr. 1 Tiranë E-mail: klsh.org.al; web-site www.klsh.org.al

Nr. 428/1 Prot.

Tiranë, më 14. 05. 2020

V E N D I M

Nr 36, Datë 14/5/2020

PËR

**ADRESIMIN E PROBLEMATIKAVE TË SHFAQURA MBI ÇËSHTJEN E
"TEATRIT KOMBËTAR" DHE PROPOZIMIN PËR PEZULLIMIN E
VENDIMARRJEVE MBI KËTË OBJEKT NGA KRYETARI I BASHKISË DHE
KËSHILLI BASHKIAK I TIRANËS**

Në mbështetje të:

- Nenit 163, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
- Nenit 18, të Ligjit nr. 154/2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
- Nenit 1, të Deklaratës së Limës mbi udhëzimet e auditimit (1977) të INTOSAI-t, ku përcaktohet se, "Auditimi është komponent i domosdoshëm i një sistemi rregullator, i cili ka për qëllim të zbulojë devijimet nga standardet e pranuar dhe shkeljet e parimeve të ligjshmërisë, eficiencës, efektivitetit, ekonomisë si dhe të menaxhimit financiar. Ky sistem do të bënte të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese në raste të veçanta, rritjen e përgjegjshmërisë, marrjen e kompensimit, si dhe parandalimin e shkeljeve të tilla";
- Nenit 3, të Deklaratës së Meksikës (2007), që konfirmon se "SAI-t duhet të kenë liri të plotë në kryerjen e përgjegjësive të tyre, ata duhet të bashkëpunojnë me qeveritë apo subjektet publike që përpiqen të përmirësojnë përdorimin dhe menaxhimin e fondeve publike";
- Pikës 3, të Rezolutës A/66/209, datë 22 dhjetor 2011, të Asamblesë së 66-të të Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, "Promovimi i eficiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës në administrimin publik, duke forcuar rolin e Institucioneve Supreme të Auditimit";
- Standardit Ndërkombëtar të Auditimit ISSAI 12 "Vlerat dhe Dobitë e Institucioneve Supreme të Auditimit - Sjellja e ndryshimeve në jetën e qytetarëve", Parimi nr. 7, "Të jesh një burim i besueshëm idesh dhe udhëzimesh të pavarura dhe objektive për të mbështetur ndryshimet e dobishme në sektorin publik";

Në kushtet që:

- Presidenti i Republikës ka dekretuar kthimin për rishqyrtim në Kuvend të Ligjit nr. 37/2018 “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt: Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar”, si dhe ka depozituar në Gjykatën Kushtetuese kërkesën për shfuqizimin e tij;
- Gjykata Kushtetuese ka vendosur të marrë në shqyrtim paraprak kërkesën e Presidentit të Republikës për të shfuqizuar ligjin special që i hap rrugë shembjes së Teatrit Kombëtar dhe ndërtimit të kullave në pronën publike dhe mbi këtë bazë u ka kërkuar Kuvendit, Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Kulturës dhe Bashkisë e Tiranës të japin argumentet e tyre mbi hartimin dhe miratimin e këtij ligji special;
- VKM nr. 377, datë 8.5.2020 “Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pasurisë nr. 1/241, me emërtimin “Teatri Kombëtar”, në zonën kadastrale 8150, Tiranë” është ankimuar për shfuqizim në Gjykatën Kushtetuese nga Presidenti i Republikës me datë 14.5.2020;
- Vendi vijon të jetë nën gjendjen e pandemisë dhe fatkeqësisë natyrore, të shpallur me VKM nr. 243, datë 24.3.2020;
- SAI-et duhet të demonstrojnë vazhdimisht rëndësinë e tyre, duke iu përgjigjur në mënyrën e duhur sfidave të qytetarëve, pritshmërisë së palëve të ndryshme të interesit, risqeve të reja dhe ndryshimeve të mjedisit në të cilin ato operojnë, e në kuadër të reagimit qytetar dhe i shoqërisë civile, artikuluar sidomos nga “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”, drejtuar me kërkesë zyrtare KLSH për këtë çështje, ardhur në KLSH me datën 11.5.2020, me nr. 428 prot.;
- KLSH e konsideron çështjen e “Teatrit Kombëtar” me ndjeshmëri të lartë publike dhe në këndvështrimin e auditimit si “materiale” për nga konteksti i saj, pasi ka lidhje të drejtpërdrejta me ruajtjen edhe konservimin e vlerave të trashëgimisë kulturore, identitetit kombëtar e të kujtesës historike, si dhe në mbrojtje të pronës publike;
- Misioni i KLSH-së si institucion i pavarur kushtetues, që ka mandat dhe diskrecion të plotë në kryerjen e funksioneve të tij dhe dhënien e rekomandimeve për mbrojtjen e pasurisë publike, ka përcaktuar si kauzë që t’i shërbejë qytetarit shqiptar, të veprojë si “agjent” i Kuvendit dhe palëve të interesit, duke i informuar në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë, mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në përdorimin e kontributit të taksapaguesve shqiptarë, duke kontribuar në përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet luftës kundër korrupsionit;
- KLSH është e angazhuar për të shfrytëzuar energjitë e përtëritura, të krijuara nga komunikimi midis saj dhe qytetarëve të vendit, si dhe në mënyrë të vazhdueshme i ka kërkuar Parlamentit ndërmarrjen e nismave ligjore për krijimin e një përgjegjësie më të madhe të qeverisë dhe institucioneve që financohen nga taksat publike, nëpërmjet hartimit të ligjit mbi përgjegjësinë materiale të zyrtarëve publikë dhe raportimit në mënyrë të paanshme e objektive për çështjet që shqetësojnë qytetarët, të tilla si korrupsioni dhe zhvillimi i qëndrueshëm;

- KLSH përpiqet të ruajë dhe parandalojë Kryetarin dhe Këshillin Bashkiak të Tiranës nga veprimet dhe vendim-marrjet e pa bazuara ligjërisht, dhe mungesës së Vendimit të Gjykatës Kushtetuese, gjë që mund të sjellë pasoja të rënda financiare e sociale;
- KLSH, në respektim të pavarësisë institucionale dhe ushtrim të përgjegjshmërisë publike për të shërbyer si një zë i besueshëm me qëllimin e sjelljes së ndryshimeve të dobishme, përmes rekomandimeve të saj mund të sjellë përmirësime në jetën e qytetarëve dhe forcimin e sektorit publik, si dhe ruajtjen e pasurisë publike dhe përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve publike,

V E N D O S A:

- 1. T'i rekomandoj Kryetarit të Bashkisë Tiranë dhe Këshillit Bashkiak të Tiranës të pezullojnë të gjitha veprimet dhe vendim-marrjet në lidhje me pasurinë nr. 1/241, me emërtimin "Teatri Kombëtar", në zonën kadastrale 8150, Tiranë, deri në dhënien e një vendimi përfundimtar nga ana e Gjykatës Kushtetuese.**

Kontrrolli i Lartë i Shtetit e konsideron të një rëndësie të veçantë rekomandimin e mësipërm, jo vetëm për faktin se është Gjykata Kushtetuese e cila zgjidh mosmarrëveshjet e kësaj natyre, por edhe për rrethanat shumë të vështira ekonomike dhe sociale që po kalon vendi ynë si pasojë e gjendjes së jashtëzakonshme të fatkeqësisë natyrore.

Nisur nga historiku i kësaj çështjeje që me Ligjin nr. 37/2018 "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt "Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar", i cili është kthyer për rishqyrtim në Kuvend nga Presidenti i Republikës me datë 27.07.2018, si dhe Komisioni Evropian e ka inkurajuar qeverinë shqiptare që të sigurojë përputhshmërinë me rregullat e prokurimit të BE-së dhe akses të barabartë dhe jo diskriminues në treg, gjë që ka shmangur pasojat negative ekonomike dhe financiare që mund të vinin nga veprimet e nxituara në këtë drejtim.

Kontrrolli i Lartë i Shtetit, nëpërmjet këtij rekomandimi, kërkon që të shmangë dëmtimet si të pasurisë kombëtare të parikuperueshme në të ardhmen, ashtu edhe të fondeve publike që mund të vijnë nga veprimet e njëanshme nga të zgjedhurit dhe organet e pushtetit vendor, para efekteve juridike të vendimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me këtë çështje.

Kontrrolli i Lartë i Shtetit do të ndjekë me vëmendje të shtuar këtë çështje në zbatim të funksioneve kushtetuese për auditimin mbi përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve shtetërore nga organet e pushtetit qendror dhe atij vendor.

Për sa më lart, Kontrrolli i Lartë i Shtetit, bazuar në Ligjin nr. 154/2014 dhe Standardet Profesionale të Auditimit, për të vlerësuar rregullshmërinë e këtij procesi dhe shqyrtimin e vendim-marrjes mbi respektimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi nga titullarët dhe organet e zgjedhura apo të emëruara, do të rishikojë planin vjetor

të auditimeve, për të përfshirë kryerjen e këtij auditimi, me përfundimin e disa angazhimeve audituese të ndërmarra kohët e fundit në Bashkinë e Tiranës.

2. Pasojat e veprimeve dhe mosveprimeve të zyrtarëve dhe institucioneve, që do të burojnë nga vendim-marrjet e padrejta, në kushtet kur Gjykata Kushtetuese të shprehet se do t'i konsiderojë të kundërligjshme dhe të gabuara, do të trajtohen nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit si dëm me pasoja të rënda për interesat ekonomike të shtetit dhe do të kërkohet dëmshpërblimi përkatës.
3. Ky vendim përcillet në formë rekomandimi *ex-ante* në Bashkinë e Tiranës. Me shprehjen e vendim-marrjes së Gjykatës Kushtetuese dhe ezaurimin e auditimit përkatës në Bashkinë Tiranë, ky vendim do të plotësohet dhe marrë formën përfundimtare *ex-post*.
4. Për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm dhe Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

Bujar LESKAJ

KRYETARI

